

D E K R E T
Nr.1217, datë 25.9.1995

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 “PËR TARIFAT DOGANORE”,
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7675, DATË 2.3.1993, NR.7790, DATË 9.2.1994 DHE LIGJIN
NR.7936, DATË 18.5.1995**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore”, në nenin 20, me ndryshimet përkatëse shtohet shkronja “k” me këtë përmbajtje:

“Për mallrat e importuara në Republikën e Shqipërisë në përputhje me marrëveshjet qeveritare dhe fondacionet të miratuara nga Këshilli i Ministrave para datës 1 korrik 1995, ku parashikohen shprehimisht përjashtimet nga taksat doganore”

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miratuar me ligjin nr.8018, datë 26.10.1995 të Kuvendit Popullor.